

| | | | |
|---|-----------------------------|------------------|-------------|
| Prenant/Contractor/Id. Number: 08-08-2024 | | | |
| Nr. Komunitar/Comm. No. | Nr. Identifikues/Ident. No. | Shërbimi/Service | Vlera/Value |
| 02- | 370/03- | 1036 | |

| | | |
|---|--|---|
|  | Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo Komuna e Vitisë Opština Vitina-Municipality of Vitina |  |
| ZYRA E PROKURIMIT | | |

KONTRATË KORNIZË PËR SHËRBIME

| | |
|-------------------------------|-------------------|
| Nr. i Prokurimit ¹ | 657-24-5858-2-1-1 |
| Nr i brendshëm | VI657-24-031-211 |

TITULLI I KONTRATËS: Mirëmbajtja verore dhe dimrore e rrugëve në territorin e komunës së Vitisë-dy vjeqar

E LIDHUR NË MES TË

| Operatori ekonomik | Autoriteti kontraktues |
|--|--|
| "Company Zuka Commerce" Sh.p.k., Metush Krasniqi nr.135, 60 000, | Komuna e Vitisë |
| Përfaqësuar nga: | Përfaqësuar nga: |
| Muhadin Zuka, drejtor | Fadil ABAZI, zyrtar përgjegjes i prokurimit |
|   |   |

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

PJESA I E KONTRATËS:

KONTRATA

Komuna e Vitisë, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë; dhe

"Company Zuka Commerce" Sh.p.k., Metush Krasniqi nr.135, 60 000,, .. (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë: Mirëmbajtja verore dhe dimrore e rrugëve në territorin e komunës së Vitisë-dy vjeçar. me numër prokurimit: VI657-24-5858-2-1-1

Neni 1: Lënda

Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: **Mirëmbajtja verore dhe dimrore e rrugëve në territorin e komunës së Vitisë-dy vjeçar.**

[Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet] ose

[Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese]

[Në rast së në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese shëno]

[Përdorimi i kësaj kontrate publike kornizë është i detyrueshëm për të gjithë Autoritetet Kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe NUK detyrojnë Autoritetin Kontraktues të blejë ndonjërin prej tyre. Autoriteti Kontraktues me të drejtë të tij mund të blejë më pak ose më shumë sasi se sa ato sasi të vlerësuara për artikull p.sh brenda një pjese (foti) të njëjtë. Megjithatë, Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e **08.08.2024** dhe përfundon në datën **07.08.2026**

Neni 2: Çmimi

2.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

2.2 Vlera totale indikative e kontratës është: **199,970.00 €** (Njëqind e nëntëdhjetë nëntemijë e nëntëqind e shtatëdhjetë Euro). Devijimi i lejuar nga vlera totale indikative është [**30 %**]

2.3 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.4 Kontrata ka objekt të transportit për një nxënës, por në rast të paraqitjes së nevojës edhe për një tjetër nxënës, në kushte të njëjta dhe me çmim të njëjtë, kjo kontratë mund të rritet edhe për çmimin e njëjtë mujor.

2.5 Kjo kontratë në kushte të pandryshueshme çmimi, sasi dhe vlere, nëse dakordohen dy palët kontraktuese, mund të vazhdohet edhe për një afat kohëzgjatje sa është kjo kontratë.

2.6 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3: Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;

(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;

- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

| Për Ofruesin e Shërbimeve | | Për Autoritetin Kontraktues | |
|---------------------------|---|-----------------------------|--|
| Emri: | Muhadin Zuka | Emri: | Fadil ABAZI |
| Pozita: | Drejtor | Pozita: | Zyrtar përgjegjës i prokurimit |
| Nënshkrimi: |  | Nënshkrimi: |  |
| Data: | 07.08.2024 | Data: | |
| Vula: |  | Vula: |  |

Zyrtari Kryesor Financiar

| | |
|-------------|---|
| Emri: | Sokol HALITI |
| Pozita: | Kryetari i Komunës |
| Nënshkrimi: |  |
| Data: | 08.08.2024 |
| Vula: | |

PJESA II E KONTRATES

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizimet

- 1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.
- 1.2 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 **"Ofrues i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
 - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguroesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguroesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.
- 4.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.
- 4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeht lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.
- 4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.
- 4.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve, ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Ofruesit të Shërbimeve, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesit, Ofruesi i Shërbimeve duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë të Autoritetit kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Tatimet dhe Doganat

- 5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.
- 5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

- 6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.
- 6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzojë Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.
- 6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të fillojë shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrimit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.
- 6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundojë aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktivitetëve.
- 6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.
- 6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

- 7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritët se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:
- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
 - b) forca mëdhorë siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 11.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paafësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmëroj palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e parapare në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Nderprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bejë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Nderprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura, ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafte të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Nderprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes së tillë, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij

brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afermit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veprojë në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbisht të barabarta ose më të mira se ato të identifikuara.

Neni 12 Obligimet e Autoriteti Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkojë në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbrës dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatuar pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që siguri i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i bëhet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 17

Kontrolli i kualiteti

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur.

Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

Neni 18

Korrigjimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për atë kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësojë defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19

Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

a) dëmet, dhe/ose

b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

a) Dëme të përgjithshme; ose

b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) vendim nga gjyqi; ose

b) vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK |
|-------------------------------------|----------|--|
| Përshkrimi i nenit | Nr. Neni | |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | 2.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykatës themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje ekonomike |
| | 2.2 | Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe |
| Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve | 6.1 | Që nga dita e nënshkrimit, 08.08.2024 deri me 07.08.2026 |

| | | |
|---|------|---|
| Pranimet | 6.4 | Menaxher i kontratës është Agim Misini |
| | 6.5 | Vendi i kryerjes së shërbimeve është Komuna e Vitise |
| Dëmet e likuiduara | 13.1 | Norma e dëmeve të likuiduara është [shëno përqindjen e Çmimit të Kontratës] në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është [shëno përqindjen e Çmimit të Kontratës] të çmimit final të kontratës. |
| Siguria e ekzekutimit | 14.1 | Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: 19,997.00 € |
| Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve | 15.1 | Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Automjeti motorik i Palës së Tretë [shëno shumën] b) Përgjegjësia e Palës së Tretë [shëno shumën] c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve [shëno shumën] d) Përgjegjësia profesionale [shëno shumën] |
| Parimet e përgjithshme të pagesës | 16.1 | Pagesat do të bëhen pas pranimit të shërbimeve nga ana e menaxherit. Pagesat duhet të behen konform Ligjit për financa publike. |
| Kontrolli i kualitetit | 17.1 | OE duhet të përmbahet Specifikimeve të detyrueshme teknike sikur në DT Shërbimet duhet të jene konform pershkrimitt në paramase, OE është përgjegjës për kualitetin e shërbimit. Porosia e shërbimit duhet të kërkohet 5 ditë, para fillimit të aktivitetit. Komunikimi të behet me shkrim përmes e-mailit [Shëno ose] |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedurë gjyqësore | 21.1 | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]. |

KOMUNA E VITISË

DREJTORIA PER SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERJENCË

MIREMBAJTJA VERORE DHE DIMRORRE E RRUGEVE NE TERITORIN E KOMUNES SE VITISE, 2024-2026

| Nr. | Përshkrimi | Njësia | Sasia | Çmimi per njësi € | Vlera në € |
|-----|---|----------------|----------|-------------------|------------|
| 1 | Pastrimi i rrugeve me Eskavator nga mbeturinat dhe pengesat eventuale | m ² | 600.00 | 1.00 | 600.00 |
| 2 | Hapja e kanaleve sipas nevojës për m' | m' | 1,500.00 | 0.60 | 900.00 |
| 3 | Hapja e gropave lyrja me Emulsion , përgaditja dhe bushja me asfalt-beton t-7cm. | m ² | 3,500.00 | 20.00 | 70,000.00 |
| 4 | Furnizimi ,transporti, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit të rendit të IV me zhavor fr 030-060mm, sipas nevojës | m ³ | 3,000.00 | 18.00 | 54,000.00 |
| 5 | Furnizimi ,transporti, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit të rendit të IV me material hedhurin, sipas nevojës | m ³ | 700.00 | 6.00 | 4,200.00 |
| 6 | Furnizimi ,transporti, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit të rendit të IV me material 1,2,3,4. sipas nevojës. | m ³ | 400.00 | 15.00 | 6,000.00 |
| 7 | Prerja e asfaltit sipas nevojës | m ² | 9,600.00 | 0.30 | 2,880.00 |
| 8 | Pastrimi i banit nga bankinat e rrugëve, 2 m nga skaji i rrugës, horizontalisht, vertikalisht sipas nevojës ku ka drunje (shkurre dhe largimi i tyre deri ne lokacionin e caktuar nga komuna) që paraqesin | km | 300.00 | 10.00 | 3,000.00 |
| 9 | Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e kubëzave me trashësi t=8 cm (te gjitha dizajnet) | m ² | 100.00 | 10.00 | 1,000.00 |
| 10 | Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e kubëzave me trashësi t=6 cm dhe rehabilitimi i trotuareve (te gjitha dizajnet) | m ² | 300.00 | 7.00 | 2,100.00 |
| 11 | Largimi i bores nga rruget (nje kors) e asfaltuar dhe të rendit të IV sipas nevojës | km | 1,200.00 | 10.00 | 12,000.00 |




| | | | | | |
|----|---|----------------|----------|-------|-----------|
| 12 | Largimi i borës nga rrugët (nje korsi) e asfaltuara dhe Hudhja e rëres dhe kripes në rrugët e asfaltuara dhe të rendit të IV ,sipas nevojës. | km | 1,200.00 | 14.00 | 16,800.00 |
| 13 | Hudhja e rëres dhe kripes në rrugët (një korsi) e asfaltuara dhe të rendit të IV ,sipas nevojës. | km | 600.00 | 12.00 | 7,200.00 |
| 14 | Transportimi me mjet transporti, ngarkim-shkarkim deri 3.5t-7,5të ndryshem sipas nevojës së Komunës | km | 500.00 | 1.00 | 500.00 |
| 15 | Furnizim me kapak të betonit , Ø800 dhe Ø1000, për puseta të betonit | copë | 100.00 | 10.00 | 1,000.00 |
| 16 | Furnizim me rrjeta metalike per pesh 60 tonë si dhe gypi I betonit për ujëmbledhja 34X34 cm. | copë | 50.00 | 40.00 | 2,000.00 |
| 17 | Furnizimi me kapak metalik (komplet), per pesha 60 tone per puseta te betonit Ø600, Ø800 të knalizimit fekal {kapak} dhe rregullimi me beton | copë | 50.00 | 50.00 | 2,500.00 |
| 18 | Vendosja e mbrojteseve të metalit në prereje tërthore të Lumit-prrockave dhe ngjyrosja rezistuese ndaj ujit për metal (gyp Ø 70 muri I gypit 2mm) | m ² | 80.00 | 35.00 | 2,800.00 |
| 19 | Furnizimi, transporti dhe vendosja e Prerja e skajoreve ekzistuese, nivelizimi I skajoreve dhe trotuarit me asfalt etj. | m ² | 50.00 | 12.00 | 600.00 |
| 20 | Elementet e betonit që shërbejnë si murë mbrojtës nga rreshqitja e dheut ,1 m X 1.2m. | m ² | 100.00 | 1.00 | 100.00 |
| 21 | Varrosja e kafsheve të ngordhur,transportimi,ngarkim-shkarkimi | copë | 30.00 | 50.00 | 1,500.00 |
| 22 | Pastrimi i rugeve lokaleve nga zhavori dhe rrëshitja e dheut në rrugë. | copë | 40.00 | 19.00 | 760.00 |
| 23 | Pastrimi dhe formesimi I kanaleve egzistuese të prockave dhe largim I shkurrëve ,Lumit Morava | m ³ | 200.00 | 5.00 | 1,000.00 |
| 24 | Beton MB30 | m ³ | 5,000.00 | 0.50 | 2,500.00 |
| 25 | | m ³ | 30.00 | 30.00 | 900.00 |

Handwritten signature



| | | | | | |
|----------------|--|----|--------|-------|-------------------|
| 26 | Rrenim i objekteve, dhe punë tjera me eskavator, sipas nevojës | h | 90.00 | 5.00 | 450.00 |
| 27 | Transportimi me mjet transporti, ngarkim-shkarkim prej 7,5 tonë deri 20 tonë, të ndryshëm sipas nevojës së Komunës | km | 400.00 | 1.20 | 480.00 |
| 28 | Vendosja-montimi, betonimi i puhive të zingura mbrojteseve të metalit në skaj të rrugës ku paraqitet nevoja | m² | 110.00 | 20.00 | 2,200.00 |
| Totali: | | | | | 199,970.00 |

| IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE) | |
|---|--|
| EMRI I OE: | "Company Zuka Commerce" Sh.p.k. |
| EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TE OE: | Muhadin Zuka |
| NËNSHKRIMI: |  |
| DATA: | 08.07.2024 |
| VULA: | |



1. 
2. 
3. 



SCARDIAN
SIGURIME

0053960

| | |
|----------------------------------|--|
| NUMRI I POLICËS | 053960 |
| SIGURUESI | K.S. SCARDIAN J.S.C Adresa: Rr. Perandori Justinian 3, 10000 Pristine, Kosovo |
| AGJENTI | Besart Fejzullahu Adresa: Rr. Marie Shllaku - p/n |
| I SIGURUARI | COMPANY ZUKA COMMERCE SH.P.K Adresa: Metush Krasniqi p.n |
| NUMRI I BIZNESIT | 810281949 |
| NUMRI FISKAL | 810281949 |
| QËLLIMI I SIGURIMIT | Garanci e Kontratës |
| PËRFITUESI | KUVENDI KOMUNAL VITI |
| TITULLI I KONTRATËS | MIREMBAJTJA VERORE DHE DIMRORE E RRUGEVE NE TERRITORIN E KOMUNES SE VITISE |
| NUMRI I IDENTIFIKIMIT-PROKURIMIT | 657-24-5858-2-1-1 |
| TERRITORI I MBULIMIT | Republika e Kosovës |
| PERIUDHA E SIGURIMIT | 761 ditë |
| SHUMA E SIGURUAR | 20,000.00 EURO |
| Nga: | 07-08-2024 |
| Deri: | 07-09-2026 |
| PRIMI I SIGURIMIT | 750.00 |
| TVSH 18 % | 135.00 |
| PRIMI +TVSH 18% | 885.00 |
| DATA E LËSHIMIT | 2024-08-07 10:33:15 |

VËREJTJE: NR I BRENDSEHM: 657-24-031-211

Polica e sigurimit të Garancive është krijuar në bazë të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më datë 10.05.2012, gjithashtu sipas Rregullave dhe Rregulloreve të Aprovuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Pjesë përbërëse e kësaj police janë Kushtet e përgjithshme, pyetësori i plotësuar dhe të nënshkruar dhe çfarëdo dokumenti tjetër i bashkangjitur me me policën e sigurimit.

Kjo policë sigurimi vërteton lidhjen e kontratës, dhe lëshohet nga Siguruesi në bazë të deklaramëve dhe kërkesave të bëra nga i Siguruar/përfaqësuesi i të siguruarit, i cili është përgjegjës lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e deklaramëve të bëra prej tij.

Unë i Siguruar/përfaqësuesi i të siguruarit, deklaroj se i kam lexuar me vëmendje dhe i kam kuptuar kushtet e kontratës së sigurimit, deklaroj se pajtohem me to, si dhe me të dhënat dhe përcaktimet e kësaj police sigurimi, dhe po nënshkruaj konform vullnetit tim të lirë, e të plotë.

I SIGURUARI

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

SCARDIAN

(emri, mbiemri, nënshkrimi)



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| | | | |
|--|-------------------|--------------------|-------------------|
| Pratimja e Prokurimit të Dena 08-08-2024 | | | |
| Nr. i kontratës Cm. Dena | Numri i kontratës | Niveli i kontratës | Vendi i kontratës |
| 02- | 055/02- | | 1035 |



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VITISË

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik, në bashkëpunim, dhe propozim të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, më dt. 26.07.2024 merr:

V E N D I M

për

Emërimin e Menaxherit të Kontratës dhe Emërimin e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejt të Menaxherit të Kontratës

1. Caktohet Menaxheri i kontratës si dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: **Mirëmbajtja verore dhe dimrore në territorin e komunës së Vitisë-dy vjeqar, Nr.br.VI657-24-5858-2-1-1, Nr.Br.VI657-24-011-211** si vijon :

i. Menaxher i Kontratës caktohet **Agim Misini**,

ii. Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës caktohet **Basri Aliu** (autorizues i kodit buxhetor) – **kualifikimi-Gjeolog**

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit të Kontratës si dhe rregullave tjera të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe emërimit të Menaxherit të kontratës (MK) të gjitha përgjegjësitë përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit tek Menaxheri i Kontratës

Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës:

Menaxheri i kontratës do të:

- menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;
- sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë dhe

c.bëj vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

Funksionet e Menaxherit të Projektit/kontratës janë:

- Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloi me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë

- e parë Menaxheri i kontratës brenda afatit duhet të krijoj Planin për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";
- b. Menaxheri i kontratës, duhet të lexoj kushtet e kontratës dhe të përgatis Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
 - c. Të dorëzoj Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyre të prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerr urdhër blerjen;
 - d. Pas pranimit të urdhër-bletjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendos të dhënat në platformën elektronike, të ngarkoj në platformën elektronike urdhër-bletjen dhe të përcjell të njëjtën përmes platformës tek OE, nga e cila date fillon numërimi i afatit kohor për liferim
 - e. Të sigurojë që Operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - f. Të sigurojë që Operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - g. të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - h. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
 - i. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - j. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik;
 - k. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - l. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta marr miratimin;
 - m. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve
 - n. Të jep detaje të plota për ndonjë ndërprerjeje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit; dhe
 - o. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontratë siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.

3. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

Mbikëqyrësi drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për:

- a) Monitorimin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, dhe
 - b) Rishikimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikëqyrjen e tij.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ .

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Kryetarit ;
- Zyrës së Prokurimit;
- Zyrës Ligjor;
- Menaxherit të kontratës;
- Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të menaxherit të kontratës
- Arkivit.

